

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-149/11**

**Prishtinë  
1 Nëntor 2012**

Në çështjen juridike të

**A.R.S.**

***Pala përgjegjëse në kërkesë/Ankuesi***

kundër

**D.R.**

***Paraqitësja e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-ës i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryesuese, Elka Filcheva – Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/102/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA24692), i datës 23 shkurt 2011, pas seancës gjyqësore të datës 1 nëntor 2012 muarr këtë:

## AKTGJYKIM

- 1- Hedhet si e palejueshme ankesa e A.R.S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (lëndë është e regjistruar në AKP me numër KPA24692)
- 2- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 37,50 (tridhjetë e shtatë presje pesëdhjetë euro) në Bugjetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

### Përmbledhje procedurale dhe faktike:

Me 21 shkurt 2007, D.R. si anëtare e ngushtë e familjes së bartësit të së drejtës pronësore ka paraqitur katëmbërdhjetë kërkesa pranë Agjencionit Kosovar të Pronës (AKP-ës), duke kërkuar riposelimin dhe kompenzimin për shkak të shfrytëzimit të paligjshëm të ngastrave të kërkuara. Ajo ka sqaruar se babai i saj i ndjerë ishte bashkëpronar i ngastrave të cilat ishin uzurpuar nga personi i panjohur. Me nënshkrimin e formularëve të kërkesave, D.R. ka deklaruar se prona ishte humb me datë 12 qershor 1999. Në këtë lëndë vetëm një ngastër është objekt shqyrtimi: Ngastra Nr. 2981, kullosë e cila gjendet në vendin e quajtur “Suvi Do” në Dumnice të Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 07 ari 70 m<sup>2</sup>. Lënda në AKP është regjistruar me numrin KPA24692.

Pas njoftimit të palës së interesuar për kërkesën – ose duke vënë shenjë që tregon se prona ishte objekt kërkesë, ose njoftimit në Gazetën e AKP-ës – J.S., i cili ishte – drejtor – i pretenduar i kooperativës P., që veq ishte i pranishëm gjatë disa njoftimeve, është përgjigjur në kërkesë. J.S. gjithashtu kishte paraqitur në AKP përgjigjen e A.R.S., të datës 25 shtator 2007. Me këtë dokument A.S. ishte përgjigjur në kërkesat e regjistruara me numrat KPA 24689, KPA24674, KPA24632, KPA24680, KPA24681, KPA24688, KPA24685, KPA24634, KPA24354, KPA24692 dhe KPA24699. Ai kishte deklaruar se një pjesë (4 ha) e parcelave kontestuese ishin toka të gjyshit të tij dhe atë që nga viti 1952, dhe se ai e kishte kultivuar këtë tokë që nga viti 1980. Ai gjithashtu kishte deklaruar se dokumentacioni në lidhje me këtë tokë është djegur në vitin 1999.

Me datë 23 shkurt 2011, AKP-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/102/2011 ka refuzuar kërkesat e D.R., meqë paraqitësja e kërkesave nuk kishte provuar ekzistimin e të drejtës pronësore private mbi palujtshmëritë në emrin e babait të saj.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me datë 14 dhjetor 2011, A.S. me 6 korrik 2011.

Me 31 gusht 2011, pala përgjegjëse në kërkesë A.S. (mëtitje: ankuesi), ka ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme, për sa i përket lëndës KPA24692. Ai ka kundërshtuar vendimin për arsye të shkeljes së ligjit material dhe procedural dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka kërkuar që vendimi i atakuar të prishet dhe që atij ti njihet e drejta e pronësisë. Ai ka deklaruar se familja e tija i ka shfrytëzuar 4 ha të pronës [me këtë me sa duket ka bërë lëshim meqë prona që ishte e përfshirë me lëndën KPA24692 ishte më e vogël se aq.

Ankesa i është dorëzuar D.R. në dhjetor 2011, ajo është përgjigjur me 30 janar 2011. Ajo ka përsëritur se e gjitha prona i takon asaj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa është e palejueshme.

Ankuesi nuk ka të drejtë në ankesë. E drejta e ankesës iu është dhënë atyre – dhe vetëm atyre – personave, të cilët janë prekur negativisht nga vendimi i konestuar. Sidoqoftë, vendimi i KKKP-ës, nuk ka pasur efekt ligjor negativë në ankuesin. Përkundrazi, me vendimin e tij KKKP-ja ka refuzuar kërkesat e D.R.. KKKP-ja nuk ka vendosur në kërkesën e palës përgjegjëse në kërkesë meqë kjo nuk do të ishte brenda jurisdiksionit të KKKP-ës. KKKP-ja duhej të vendoste në kërkesat me të cilat paraqitësi i kërkesës theksonte se ai/ajo kishte humbur pronën për shkak të konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999 në Kosovë. Pala përgjegjëse asnjëherë nuk kishte paraqitur kësi lloj kërkesë formale e cila do të duhej paraqitur deri në fund të vitit 2007 (Neni 8 i Udhëzimit Administrativ 2007/5 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079) sikur që ai asnjëherë nuk kishte pretenduar se kishte humbur pronën për shkak të rrethanave drejtëpërdrejtë të lidhura me konfliktin e armatosur (Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079). Në KPA24692 ankuesi ka vepruar vetëm si palë përgjegjëse në kërkesë, KKKP-ja ka mund që mbi bazën e dispozitave ligjore të mos vërtetojë të drejtën e pronësisë së paraqitësit të kërkesës D.R., dhe ka vendosur të mos e bëjë

këtë. Prandaj, meqenëse vendimi nuk ka pasë kurrfarë efekti negativ ligjor në ankuesin, ankuesi nuk ka të drejtë ankese në këtë vendim.

Gjykata dëshiron të shtojë se ankesa gjithashtu ishte e paafatshme. Ankesa duhet të ushtrohet mbrenda periudhës kohore prej 30 ditësh pas dorëzimit të vendimit palës (Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079); shih gjithashtu nenin 196 të Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore. Ankuesi kishte ushtruar ankesën pas 6 gushtit të vitit 2011, me 31 gusht 2011. Kjo është më shumë se tri javë shumë vonë. Ankuesi deklaroi se ai nuk ka mundur të ushtronte në kohe ankesën për shkak se ishte i sëmurë. Dëshmitë që ai i kishte dhënë Gjykatës, të datës 2 qershor dhe 2 korrik 2011 dëshmojnë vetëm “pamjaftueshmërinë vasorum cerebri dhe hypertension arterialis”. Këto nuk janë arsye për të cilat ankuesi nuk kishte mundur të ushtronte një ankesë ose që t’i kërkonte ndonjë personi tjetër ti ndihmonte të bënte këtë.

Vendimi i Gjykatës nuk paragjykon të drejtën e ankuesit që të kërkojë vërtetimin e të drejtës së tij pronësore para autoriteteve lokale kompetente.

#### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, 10.12, 10.1 dhe 10.15 përshtatshëmrisht të UA 2008/2) duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të përlllogaritet të jetë si € 700: € 7,50( gjysma e pjesës së taksës sipas numrit të tarifës 10.1 e cila do të ishte € 15)

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin.

Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave është 15 ditë. Neni 47.3 parashih që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit prej 15 ditësh, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Këshillë Ligjore**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike

**Anne Kerber, Gjyqtare Kryesuese e EULEX-it**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtarë**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**